



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 3298/2 Prot

Pogradec, më 13.08.2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK


E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, për: “Për marrjen me qira sipërfaqe truall + ndërtesë për qëllime magazinimi dhe shërbimi”.

Me respekt,

KRYETARI

MANJOLA KAMOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i faqeve A3 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr. 3288/2 Prot

Pogradec, më 13.08.2026

RELACION

Në lidhje me Projekt -Vendimin për "Per marrjen me qira sipërfaqe toke/truall + ndertesë për qëllime magazinimi dhe shërbimi",

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Në lidhje me marrjen me qira të një ndërtese dhe trualli për mbajtjen e automjeteve të shërbimit të pastrimit të vijës breg-liqenore dhe ngritjen e Brigadës nr. 4, datojnë si më poshtë:

Me ngritjen e Brigadës nr.4 e cila ka si funksion kryesor pastrimin e liqenit dhe menaxhimin e mbetjeve që do të grumbullohen gjatë këtij procesi. Kjo brigadë do të angazhohet jo vetëm në pastrimin, por edhe në përpunimin e mbetjeve organike të mbledhura

Në kuadër të përmirësimit të kushteve mjedisore dhe rritjes së eficiencës së shërbimit të pastrimit, paraqitet nevoja për marrjen me qira të një ndërtese së bashku me truallin përreth, e cila do të shërbejë për strehimin dhe parkimin e automjeteve që do të përdoren për pastrimin e të gjithë vijës breg-liqenore.

Këto automjete do të jenë pjesë përbërëse e shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së zonës, duke garantuar ndërhyrje të vazhdueshme, të organizuara dhe efektive në mbledhjen e mbetjeve përgjatë vijës breg-liqenore, si dhe në sipërfaqen e liqenit.

Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, kryen verifikimet ne terren me qëllim evidentimin e një pasurie të përshtatshme, por asnjë nga pasuritë e paluajtshme nuk paraqet karakteristikat e përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit të Brigadës nr.4, konkretisht për:



Grumbullimin dhe magazinim e përkoshëm të mbetjeve të nxjerra nga pastrimi I Liqenit

Kompostimin e mbetjeve me qëllim përpunimin e tyre dhe kthimin në pleh organik.

Sistemimin dhe parkimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si traktorë, kamionë, eskavator si dhe dy mjete të tjera që priten të dhurohen N.P.R, 1 (një) mjet Shredder (Grirës), dhe 1 (një) mjet Turner (Rrotullues) të cilat do të bëjnë të mundur që të kryhet I gjithë poroçesi e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta të cilat dalin nga liqeni.

Mbetjet organike, pas përpunimit, do të shndërrohen në pleh organik, të cilat do të vihen në dispozicion të Bashkisë Pogradec si dhe Njësive Administrative për përdorim bujqësor, duke kontribuar në zhvillimin e bujqësisë. Ky proces do të sjellë një përfitim të dyfishtë, kompostimin e mbetjeve të gjelbra të nxjerra nga liqeni dhe mbështetjen e Njësive Administrative në menaxhimin dhe përdorimin e tyre në mënyrë të dobishme.

Marrja me qira e kësaj ndërtese dhe trualli është një domosdoshmëri funksionale për garantimin e mbarëvajtjes së shërbimit, sigurimin e mjeteve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për organizimin e punës së brigadës për pastrimin e liqenit.

Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit synon përmirësimin e ndjeshëm të gjendjes mjedisore të vijës breg-liqenore, duke I ofruar komunitetit një mjedis sa më të pastër.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Gentjan KAMOLLI

Pranoi: Luan BALLA

Miratoi: Arben BEKTASHA

Konfirmoi: Dritan BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. ____ . Prot

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ .2026

PËR

**“MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROÇEDURAVE
PËR MARRJEN ME QIRA, SIPËRFAQE TOKE/TRUALL + NDËRTESË PËR
QËLLIME MGAZINIMI DHE SHËRBIMI, PËR NEVOJA TË NDËRMARRJES SË
PARQEVE DHE REKREACIONIT PRANË BASHKISË POGRADEC”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

VENDOSI:

1.Të miratojë normat, kriteret, rregullat, procedurat, afatin dhe vlerën e qirasë për marrjen e sipërfaqes toke/truall ndërtësë në zonën kadastrale 1298, me sipërfaqe minimum 500 m2 dhe maksimum 700 m2, dhe me sipërfaqe ndërtësë minimum 150 m2 dhe maksimum 300 m2, të cilat do të shërbejnë për vëndosjen e automjeteve, si kamjon, traktor, eskavator dhe mjeteve të tjera ndihmëse, si dhe për përpunimin e mbejtjeve të cilat do të nxirren nga liqeni dhe më pas do të përpunohen dhe do të shndërrohen në pleh organik.

2.Të miratojë Porçedurën Konkurruese si vijon:

2.1 Struktura e posaçme e krijuar me urdhër të Drejtorit të N.P.R, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit në buletin e publikimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.

2.2 Afati i paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 10 (Dhjetë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.

2.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar me urdhër të Drejtorit të Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, brenda 5 (Pese) ditëve nga data e hapjes se ofertave, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të regullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertueseve.

2.4 Subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, t'iu njihet e drejta të ankohen, me shkrim, pranë Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 7 (Shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

2.5 Në përfundim të afateve të ushtrimit të së drejtës së ankimimit, kryetari i K.V.O i paraqet Drejtorit, një raport përmbledhës dhe i propozon për miratimin e fituesit të procedurës konkurruese.

2.6 Në përfundim të hapave të mësipërme, autorizohet Drejtori I Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit për nënshkrimin e kontratës së qirasë.

3.Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në 5 vjet.

4.Për zbatimin e këtij projekt-vendimi do të ngarkohet Ndërmarrja së Parqeve dhe Rekreacionit.

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 328 Prot
2

Pogradec, më 13.08.2026

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

**“MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE
PËR MARRJEN ME QIRA, SIPËRFAQE TOKE /TRUALL + NDËRTESE PËR
QËLLIME MAGAZINIMI DHE SHËRBIMI, PËR NEVOJA TË NDËRMARRJES SË
PARQEVE DHE REKREACIONIT, PRANË BASHKISË POGRADEC ”**

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar:
“Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton:
“Akt me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në Nenin 8 shkronja “a” përcakton se : “është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.”



Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

“Akti normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1, shkronja “a” e Kodit të Proçedurës Administrative jep këtë perkufizim për “aktin administrativ”:

a) **“Akti administrativ individual”** është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) **“Akti administrativ kolektiv”** është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij Projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një **akt administrativ me karakter normativ**, i cili plotëson elementet e përcaktuar në Nenin 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Ky projekt-vendim që paraqitet për miratim, përcakton rregulla të përgjithshme për sipërfaqen minimale dhe maksimale të tokës, ndërtesës, qëllimin e përdorimit, procedurën konkurruese, afatet, të drejtën e ankimit dhe kohëzgjatjen e kontratës. Këto rregulla nuk i drejtohen një personi të përcaktuar, por një kategorie të papërcaktuar subjektsh që mund të marrin pjesë në procedurë. Nevoja për marrjen me qira të kësaj pasurie lidhet me garantimin e kushteve të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, veçanërisht për organizimin e shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së vijës breg-liqenore.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë, sipas legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: N. NAUN

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI